



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rruga Ukshin Kovaqica, Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 492/004
Dt 26.03.2019

Në bazë të nenit 48 pika 1.3, nenit 154 dhe nenit 159 të Statutit të Përkohshëm, si dhe në zbatim të nenit 3 dhe nenit 9.1. të Rregullores nr. 1201 për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 19.03.2019, mori:

VENDIM

1. **MSc. Berat Ujkani, PhD cand**, zgjidhet **asistent** për lëndët e Informatikës inxhinierike, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike.
2. Zgjedhja e të përmendurit është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 159 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit dhe nenit 9.1. të Rregullores nr. 1201 për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në UMIB.
3. I përmenduri është i obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statutit të Përkohshëm të Universitetit.
4. Zgjedhja zgjat për periudhën 3 (tre) vjeçare.
5. Të përmendurit i takon paga në pajtim me Rregulloren për të ardhura personale të UMIB-it.
6. Kontrata e punës me të përmendurin do të lidhet pas përfundimit të procedurave të rregullta të ankesave dhe pas deklarimit për pagë primare në UMIB.

Arsyetim

Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një asistenti për lëndët e Informatikës inxhinierike, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike.

Komisioni i Studimeve e ka shqyrtuar raportin e Komisionit recensues dhe i ka propozuar Senatit të Universitetit që MSc. Berat Ujkani të zgjidhet asistent për lëndët e sipërpërmendura.

Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 19.03.2019, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit për Studime, vendosi që MSc. Berat Ujkani të zgjidhet asistent për lëndët e Informatikës inxhinierike, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike.

Në bazë të kësaj që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Senatit të Universitetit.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Fakultetit;
4. Zyrës së personelit;
5. Zyrtarit për paga;
6. Zyrës për çështje akademike;


Prof. dr. Alush Musaj
Rektor i UMIB-it